

**Projekte rrejdhëse të financuara me hua nga Banka Botërore në Republikën e
Maqedonisë së Veriut
janar 2022**

Emri i projektit	Qëllimi i projektit	Vlera e huasë / grantit (milionë euro)	Viti i fillimit të projektit	Viti i përfundimit të projektit
Projekt i dytë për përmirësimin e shërbimeve komunale	<p>Qëllimi zhvillimor i këtij projekti është që të përmirësohet transparenca, qëndrueshmëria financiare dhe ofrimi i shërbimeve të caktuara komunale në komunat pjesëmarrëse në këtë projekt.</p> <p>Qëllimi i projektit është përmirësimi i performancave të ekonomive urbane dhe cilësisë së menaxhimit në nivel komunal, përmes sigurimit të përkrahjes përkatëse financiare dhe këshilldhënëse të disa komunave dhe ndërmarrjeve të tyre publike, si në pjesën e përmirësimit të shërbimeve komunale ashtu edhe në pjesën e avancimit dhe përforcimit të funksioneve dhe kompetencave të komunave.</p>	25	2016	2022
Projekt për zgjerim dhe zhvillim të rrugëve Rankovc – Kriva Pallankë	Qëllimi i këtij projekti është lidhja më e mirë e transportit përgjatë Korridorit 8 ndërmjet Shkupit dhe vendkalimit kufitar Deve Bair përmes ndërtimit të rrugës Rankovc – Kriva Pallankë, si dhe përmirësimit të funksioneve të NP-së për Rrugë Shtetërore për menaxhim dhe planifikim të mjeteve.	83	2015	2022
Projekt për avancimin e shërbimeve sociale	Projekti përfshin lloje të ndryshme të aktiviteteve: zhvillimi i politikave, vendosja e sistemit gjithpërfshirës të shërbimeve sociale dhe realizimi sistematik i shërbimeve të riformuara përmes rrjetit të zgjeruar të ofruesve të shërbimeve sociale, vendosja e sistemit të integruar të informacionit për administrimin e të drejtave dhe shërbimeve, ndihmë teknike dhe trajnime për përkrahje dhe përforcim të kapacitetit të pushtetit lokal, zgjerimi i kapaciteteve për kujdes parashkollor përmes ndërtimit të objekteve të reja dhe ridestinimi (ose zgjerim) i infrastrukturës ekzistuese të institucioneve parashkollore.	28,7	2018	2024

Projekt për lehtësimin e tregtisë dhe transportin në Ballkanin Perëndimor	Implementimi i Planit të përbashkët aksional për lehtësimin e tregtisë dhe transportit në Ballkanin Perëndimor, përkatësisht zhvillimi i Projektit rajonal për lehtësimin e tregtisë dhe transportit në Ballkanin Perëndimor, që do t'i implementojë aktivitetet e identifikuara në çdo vend. Projekti është me karakter rajonal dhe në fazën fillestare do t'i përfshijë Maqedoninë e Veriut, Serbinë dhe Shqipërinë, ndërsa më tej do të përfshihen edhe Bosnja, Mali i Zi dhe Kosova.	26,2	2019	2025
Projekt për lidhjen e rrugëve lokale	Projekti për lidhjen e rrugëve lokale do të realizohet në 80 komuna të Republikës së Maqedonisë së Veriut, me ç'rast do të realizohen aktivitete ndërtimore për rehabilitim, rikonstruim dhe zgjerim të rrugëve dhe rrugicave lokale në gjatësi të përgjithshme prej 450 km.	70	2019	2024
Projekt për administrimin e sigurimit social	Qëllimi kryesor i Projektit është përmirësimi i cilësisë së shërbimeve sa i përket administrimit të sigurimit social dhe avancimit të kornizës ligjore, që rregullon çështjet që i referohen personave me aftësi të kufizuara dhe vendeve të punës me stazh me kohëzgjatje të shtuar, gjegjësisht (stazh i beneficuar).	13,8	2020	2023
Projekt për ballafaqim urgjent me COVID-19 në Maqedoninë e Veriut	Qëllimet themelore të projektit janë që të parandalohet, zbulohet dhe reagohet ndaj kërcenimit nga virusi i koronës COVID-19 dhe të përforcohen sistemet nacionale për përgatitjen e shëndetësisë publike në Maqedoninë e Veriut.	90	2020	2022
Projekt për avancimin e arsimit fillor	Qëllimi kryesor i projektit është përmirësimi i kushteve për mësim në arsimin fillor në vend.	21,5	2021	2026
Projekt për efikasitet energjetik në sektorin publik	Qëllimet kryesore të Projektit janë zvogëlimi i konsumit të energjisë në sektorin publik dhe përkrahja e vendosjes së operacionalizimit të mekanizmit të qëndrueshëm për financimin e efikasitetit energjetik në sektorin publik.	25	2021	2025
Projekt për modernizimin e bujqësisë	Qëllimi i projektit është që të përmirësohet konkurrenca e nënsektorëve të targetuar në sferën e bujqësisë dhe të përforcohet gatishmëria e sektorit publik në sektorinë e bujqësisë për anëtarësim në BE.	46	2021	2025